

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**Projekt**

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2023

**PËR**

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 87, DATË 14.2.2018 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË GAZIT  
NATYROR NË SHQIPËRI DHE IDENTIFIKIMIN E PROJEKTEVE PRIORITARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 2 e 4, të nenit 5 dhe nenin 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

- I. Në vendimin nr. 87, datë 14.02.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:
  1. Pas pikës 1 të Vendimit Nr. 87, datë 14.02.2018, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon:  
“1/1. Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, instalimeve të GNL-së, depozitave të gazit natyror, linjave direkte, lidhjes së sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, si edhe çdo impianti, pajisjeje ose instalimi tjetër që përfshihet në sektorin e gazit natyror edhe nëse nuk janë parashikuar në Masterplan apo janë parashikuar me standarte të ndryshme, miratohen sipas parashikimeve të nenit 11 të Ligjit Nr. 102/2015 ‘Për sektorin e Gazit Natyror’”.
  2. Në Dokumentin Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor “Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF 4) – WB11-ALB-ENE-01 Master Plani i Infrastrukturës së Gazit, Raporti Përfundimtar”, bashkëlidhur vendimit nr. 87, datë 14.02.2018, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:
    - a) Në pikën 3.2, paragrafi i pestë, i dokumentit “Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF 4) – WB11-ALB-ENE-01 Master Plani i Infrastrukturës së Gazit, Raporti Përfundimtar”, përditësohet përmbajtja me dokumentin si në gjuhën Angleze, duke ndryshuar si më poshtë:  
“Shoqëria TAP AG do të ndërtojë, dhe operojë gazsjellësin TAP. Shqipëria, Greqia dhe Italia kanë nënshkruar një marrëveshje ndërqeveritare për TAP-in. Në bazë të Vendimit të Përbashkët të Enteve Rregullatore të Energjisë të Italisë, Shqipërisë, dhe Greqisë në qershor 2013, TAP AG është e detyruar të ndërtojë të paktën një pikë dalje

me dy drejtime (bidireksionale) në Shqipëri (që gjendet në Fier), me një kapacitet prej 2-10 mmk/ditë (0,73-3,65 bmk/vit). Përveç Fierit, një pikë e dytë dalje është në diskutim në zonën e Kuçovës.”

- b) Pika e parë e pikës 5.6 të dokumentit “Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturaes (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF 4) – WB11-ALB-ENE-01 Master Plani i Infrastrukturaes së Gazit, Raporti Përfundimtar” ndryshohet si më poshtë:

“Presioni Maksimal i Lejuar:

-82 bar, për seksionet e IAP dhe deri në 100 bar për pjesën tjetër të sistemit të transmetimit në Shqipëri

-Deri në 100 bar, për sistemin e transmetimit në Shqipëri kur IAP nuk ekziston”

- c) Në pikën 9 të dokumentit “Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturaes (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF 4) – WB11-ALB-ENE-01 Master Plani i Infrastrukturaes së Gazit, Raporti Përfundimtar”, në listën e prioriteteve në “Terma afatshkurtër”, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 dhe në listën e prioriteteve në “Terma afatmesëm” pas pikës 4 shtohet pika 4/1 si më poshtë:

“2/1. Zhvillimi i pikës së daljes dhe rrjetit të shpërndarjes Bashkia Korçë

4/1. Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror”

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturaes dhe Energjisë, ministritë dhe institucionet përgjegjëse, të përmendura në planin e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama